



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 08 -2009
Prishtinë, më 16. mars 2009, ora 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Bajram Kosumi, Kolë Berisha
Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj dhe Adem Hajdaraj.

Munguan: Branisllav Grbiq dhe Selvije Halimi.

Të pranishëm: Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti, Reshit Gashi - NDI, Xhavit Gaxherri – *Bota Sot*, Lumnije Murati – ZPRK, Petrit Hysaj – OSBE dhe Vlora Marmullaku – EULEX.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 9 marsit 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – I përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit, si: NDI, OSBE, EULEX dhe mjetet e informimit etj. Të pranishmit i njoftoi për rendin e ditës.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 9 marsit 2009

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit se a kanë vërejtje për procesverbalin.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3 Shqyrtimi i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore

Kryetari – Në këtë pikë të rendit të ditës e shtroi për diskutim këtë projektligj, edhe pse ishte i miratuar në parim. I pyeti anëtarët e Komisionit se a do ta procedojnë më tutje, a do ta formojnë një nënkomision apo do të punojnë si tërësi?

Adem Hajdaraj - Ishte i mendimit se për këtë projektligj duhet të punojnë si Komision dhe jo të formohet ndonjë nënkomision për shqyrtimin e tij.

Ibrahim Makolli - Shtoi do të ishte mirë të debatohet edhe me ekspertë të mjekësisë ligjore dhe me ekspertë të tjerë, që mund të japin kontribut për këtë projektligj, sepse ky i është dedikuar një sferë shumë të veçantë. Ekspertët e fushave të caktuara mund vetëm ta begatojnë. Ky takim do të kontribuonte që Projektligji të bëhet i zbatueshëm në praktikë. Pati vërejtje edhe për përdorimin e fjalëve *personat e zhdukur*, sepse në përkufizime këto përdoren vetëm në kontekst të luftës, kurse dihet se persona të zhdukur ka pasur edhe kur nuk kishte luftë.

Armend Zemaj - Shtoi se ky projektligj është shumë i rëndësishëm. Do të ishte me interes të dëgjohen edhe palët e tjera, si p.sh.: mjekësia ligjore, forenzika dhe subjekte të tjera që kanë të bëjnë me këtë projektligj.

Bajram Kosumi - Mendon se është mirë të ftohen edhe ekspertë të lëmit të këtij projektligji. Duhet të diskutohet edhe rreth bashkimit ose fuzionimit të disa institucioneve që janë të ndara - disa në Ministrinë e Shëndetësisë, disa në Ministrinë e Drejtësisë.

Adem Salihaj - Tha se në tekstin e Projektligjit në mesin e fjalës *mjekoligjor* duhet të vihet viza lidhëse (pra: mjeko-ligjor), po ashtu për fjalën *kundër efektet*, që është shkruar ndaras, propozoi të shkruhet bashkë: *kundërfektet*.

Kryetari - Shtoi se diskutimi për këtë projektligj duhet të orientohet në katër shtylla: *dispozitat e EULEKS-it, shpenzimet buxhetore, struktura organizative dhe përkufizimet.*

Në këtë pikë të rendit të ditës Komisioni konstatoi që në mbledhjen e ardhshme të Komisionit të ftohen përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, të Ministrisë së Drejtësisë, të Komisionit për Shëndetësi, të Forenzikës, të Mjekësisë Ligjore dhe mediat.

5. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës Komisioni i shqyrtoi edhe dy projektligje për bazën juridike: Projektligji për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës nr. 03-L-136 dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë nr. 03-L-136.

Kryetari – Pyeti se a pajtohen që mendimin për bazën juridike për projektligje Komisioni ta japë në fund, para dërgimit të Projektligjit në seancë plenare dhe jo në fillim, si deri më tash?

Adem Salihaj - Shtoi se baza juridike duhet të jepet në fillim, sepse kjo, mendoj unë, është drita e gjelbër për punën në vazhdim të Projektligjit, sepse kur vendosim për bazën juridike, nuk e lexojmë projektligjin nen për nen. Mendoj se për këtë çështje do të duhej të ngrihej një komision i veçantë.

Ramadan Gashi - U shpreh se baza juridike duhet jepet në fillim e jo pas shqyrtimit të projektligjit.

Ibrahim Makolli - Shtoi se projektligjet në vende të tjera kalojnë edhe në Komisionin për të Drejtat e Njeriut. Mendoj se ne, si Komision, duhet t'u bëjmë vërejtje komisioneve të tjera që amendamentet të jenë në përputhshmëri me Kushtetutën.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit u pajtuan që për bazën juridike, edhe për një kohë, të punohet si deri më tash.

Kryetari - Lexoi edhe shkresën që iu ka dërguar Komisionit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Teknologji, Rini dhe Sport për kërkesën e 125 magjistrave të shkencave të mjekësisë dhe të 80 doktorantëve legalë të vitit 2005 - 2006, si dhe të kandidatëve të tjerë të rinj të privuar për studime doktorate, të janarit 2009, sepse ky komision është edhe komision funksional.

Procesverbalin e hartoi stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni